

**Fondi “Mark Harapi” i AQSh dhe përkthimi i panjohur
i Dhiatës së Re dhe disa prurje të reja nga Arkivi i Autoritetit për
Informimin me Dosjet e Sigurimit të Shtetit**

**Fund “Mark Harapi” in the Central State Archive in Tirana; one
unknown translation of the New Testament and several other
documents from the State Security dossiers.**

Abstract: *Fr Mark Harapi S.I. was the brother of the late Fr Anton Harapi, of.m. A well-known name across Albania before 1944 – mostly for his brilliant translation of Alessandro Manzoni’s “The Betrothed” – Fr Mark was arrested in 1946 and soon afterwards imprisoned. Author Çunga reports in this article on the content of the fund bearing his name at the Central State Archive and his dossier with the State Security. Most of the documents were translations amongst which the translation of the New Testament and the Letters of St Paul.*

After having served his sentence, in 1963, Fr Mark Harapi set to work to translate the Old Testament, which unluckily must have ended somewhere else, the author says, as it does not form part of this fund. Though in internment camps, Fr Mark Harapi worked diligently on his translations. He ended his days in 1974 in Shkodra. One month later his dossier with the State Security was closed and filed away.

Gjatë punës së përditshme në Arkivin Qendror Shtetëror, pothuaj përpara dy vitesh hasëm një sasi dokumentesh (pothuaj 500 ml), të cilat mbanin etiketimin paraprak “Arqipeshkvia e Shkodrës”. Jo të gjitha dokumentet kishin lidhje me Arqipeshkvinë e Shkodrës. Pjesa më e madhe e tyre i përkiste dokumenteve të prodhuara në përgjithësi nga komuniteti katolik i Shqipërisë, kurse pjesa tjetër kishte të tjerë fondkrijues. Mes kësaj lënde hasëm në disa tufa fletësh të daktilografuara, të cilat nuk ishte e vështirë t’i identifikonim si fragmente të Dhjatës së Re. Duke shfletuar të gjithë sasinë e fletëve dhe duke i renditur, kuptuam se kishim përpara një përkthim në shqip të Dhjatës së Re. Mes atyre fletëve që u erdhi radha të renditeshin të fundit gjetëm dhe emrin e përkthyesit të tyre, Át Mark Harapit, emër shumë më pak i panjohur për publikun e gjerë se i vëllai, Át Anton Harapi.

Kritika letrare apo e përkthimit nuk është zeja jonë, prandaj në këtë kumtesë do të paraqesim shkurtimisht Fondin “Mark Harapi” që ruhet

në AQSh, si dhe përkthimin në fjalë. Duke përfutur nga funksionimi i Autoritetit për Informimin me Dosjet e Sigurimit të Shtetit, do të paraqesim këtu edhe atë fond dokumentar që ruhet në arkivin e AIDSSH dhe lidhet me Át Mark Harapin, për të mbushur sadopak informacionin e paktë të derisotshëm mbi jetën dhe veprimtarinë e Át Markut.

Përshkrim i Fondit “Mark Harapi” (nr. 716) në AQSh

Dokumentet e renditura në Fondin “Mark Harapi” të AQSh kanë mbërritur në këtë institucion në vitin 1986.¹ Janë gjithsej 11 njësi ruajtjeje të përpunuara dhe një sasi tjetër dokumentesh, përkthimi i Dhjatës së Re, është ende në proces përpunimi. Nga bisedat me arkivistë më të vjetër² mësojmë se kjo lëndë arkivore i është dorëzuar Arkivit Lokal të rrethit të Shkodrës nga Prokuroria e Rrethit të Shkodrës në gjysmën e parë të viteve 1980. Arsyeimi praktik na çon në përfundimin se kjo lëndë arkivore është marrë nga banesa e Át Mark Harapit në kohën kur i është hequr liria nga Prokuroria në vitin 1946 dhe nuk i është kthyer më kurrë. Do të ishte e pagjasë që një ish të burgosuri dhe ish të internuari politik t’i kthehej arkivi vetjak pas kryerjes së dënimeve, teksa ky arkiv ishte pjesë e provave materiale të përdorura kundër tij. Kurse për pjesën e Fondit (në përpunim) “Mark Harapi” ruajmë rezerva lidhur me mënyrën e mbërritjes në AQSh, për arsye që do t’i rendisim më poshtë.

Dosja nr. 1: Poezi shkruar nga Át Mark Harapi, dorëshkrim dhe shtypshkrim. Përmbajnë tematikë fetare, shkruar në 7 fletë.

Dosja nr. 2 dhe 2/1: Fletore që përmban përkthimin e letrave të Shën Palit. Fletorja është nxjerrë nga Fondi “Zef Hardhia (Simoni)”. Dorëshkrim, 346 fletë.

Dosja nr. 3: Fletore që përmban “Ushtrimet e shpirtit”, shqip, latinisht, italisht. Dorëshkrim, 55 fletë.

Dosja nr. 4: Fletore, Ungjilli sipas Mateut, përkthim në shqip, me parathënie. Dorëshkrim, 80 fletë.

Dosja nr. 5: Leksione teologjike dhe filozofie. Dorëshkrime latinisht dhe shqip, 98 fletë.

Dosja nr. 6: Tekste teologjike, me gjasë leksione të Át Markut, nga periudha kur ishte pedagog në Kolegjin Papnor. Dorëshkrime, 157 fletë.

Dosja nr. 7: Histori e Kishës, sipas *Corso di storia della Chiesa* nga L. Todesco. Dorëshkrim italisht, 132 fletë. Ky material më parë ka qenë vendosur në Fondin “Zef (Simoni) Hardhia”, dhe më pas është shtuar në Fondin “Mark Harapi”.

Dosja nr. 8: Tekste teologjike dhe liturgjike, ndoshta leksione. Dorëshkrime dhe shtypshkrime, latinisht, italisht dhe shqip, 64 fletë.

1 *Udhërrëfyes i Arkivit Qendror Shtetëror, Fonde personale dhe familjare*, Tiranë 2000, fq. 146.

2 Bisedë me Prof. Dr. Nevila Nika dhe arkivistin Ferid Koçi.

Dosja nr. 9: Letra shkruar nga Át Mark Harapi, ndoshta kopje të letrave të dërguara. Në njërën prej tyre i kërkon Kryetarit të Këshillit Popullor një mjedis ku mund të celebrtojë meshë, kurse tjetra është letër për një klerik anonim. Dorëshkrime shqip, 2 fletë.

Dosja nr. 10: Kartolina dhe letra të ardhura për Át Mark Harapin, dërguar nga persona të ndryshëm. Dorëshkrime shqip, 14 fletë.

Dokumente në proces përpunimi tekniko-shkencor: përkthimi i plotë i Dhjatës së Re. Teksti i përkthimit është daktilografim në gjuhën shqipe. Numrin e plotë të fletëve nuk jemi në gjendje ta japim, pasi përpunimi nuk është përfunduar. Në fazën e tanishme shohim se kemi të përkthyer 27 librat e Dhjatës së Re, secili i daktilografuar në disa kopje.

Dokumente për Át Mark Harapin nga Arkivi i ish Ministrisë së Punëve të Brendshme, sot arkivi i Autoritetit për Informimin mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSh)

Në Arkivin e AIDSSh mundëm të gjenim dy njësi ruajtjeje që lidhen me Át Mark Harapin: 1. Dosjen 1221/A, dosja gjyqësore e tij (e përbashkët edhe me persona të tjerë të akuzuar dhe dënuar bashkë me të); 2. Dosje nr. 304, Dosja formulare, kategoria II B, nr. 1519.

Dosja gjyqësore përmban 18 fletë (fl. 1^r-17^v, ku fleta 1 është me fraksion) që lidhen me Át Mark Harapin. Në to renditet proces-verbali i ndalimit të tij dhe burgimi më 05/11/1946, akuza, zhvillimi i seancës, shpallja e vendimit me 10 vjet heqje lirie më 04/01/1948 dhe proces-verbalet e marrjes në pyetje të Át Markut.

Dosja formulare nr. 1519 II B përmban 50 fletë dhe mbulon periudhën e internimit të Át Markut nga data 09.07.1957, pas lirimit nga burgu, deri në fund të jetës së tij më 10.02.1974. Raportet në dosje mbarojnë më dt. 05.03.1974³, pothuaj një muaj pasi Át Marku kishte ndërruar jetë, më 10.02.1974.

Át Mark Harapi mes burimeve të AQSh dhe arkivit të AIDSSh

Veç botimeve, për jetën dhe veprën e Át Mark Harapit pak dokumente kanë shpëtuar, mes tyre, ato të arkivit të AIDSSh. Arkivi privat i tij, pjesë e të cilit janë dokumentet e mësipërme të AQSh, është marrë nga organet e hetuesisë pas arrestimit të tij dhe është dorëzuar, prej andej, në AQSh më 1986. Nga i vetmi botim ku mundëm të gjenim të dhëna për jetën e tij, *Tragjedia dhe lavdia e Kishës Katolike në Shqipëri*⁴, hasëm në informacione për jetën e tij deri në çastin e dënimit, dhe pas lirimit nga internimi, deri në datën e vdekjes. Informohemi se Át Marku ka qenë profesor në Seminarin Papnor, ku ka dhënë filozofi, teologji dogmatike dhe besim, kurse në

3 AIDSSh, Dosje Formulare nr. 1519, kategoria II B, Át Mark Harapi, fl. 41.

4 P. PEPA: *Tragjedia dhe lavdia e Kishës Katolike në Shqipëri*, Tiranë 2007, fq. 7-12.

Kolegjin Saverian ka dhënë filozofi, letërsi shqipe dhe besim.⁵ Këto të dhëna mbështeten edhe nga prania e leksioneve, në dorëshkrime apo shtypshkrime, në njësitë e ruajtjes 3, 5, 6, 7, 8 të Fondit “Mark Harapi” të AQSh. Pjetër Pepa na informon se pas lirimit nga internimi më 1963, kur kthehet në Shkodër, At Marku fillon punën për përkthimin e Dhjatës së Vjetër, teksa Dhjatën e Re e ka përfunduar në internim.⁶ Përkthimit të Dhjatës së Vjetër nuk i kemi rënë ende në gjurmë. Shpresojmë që lënda të jetë ruajtur dhe arkivuar diku. Kurse përthimi i Dhjatës së Re ruhet, fatmirësisht, pjesërisht në dorëshkrim, dhe plotësisht në shtypshkrim, mes lëndës arkivore në përpunim e sipër në AQSh.

Njësia e ruajtjes nr. 10 e AQSh përmban letra dhe kartolina dërguar At Mark Harapit, të cilat datojnë mes viteve 1958-1963, e cila ishte dhe periudha e internimit të tij. Ndoshta këto letra




Figura 1:
Fotografi e At Mark Harapit,
marrë nga AIDSSH,
Dosje Formulare nr. 1519,
kategoria II B,
At Mark Harapi, fl. 10.




Figura 2: Dorëshkrim i përkthimit të *Dhjatës së Re*, pasthënia e At Mark Harapit për Letrat e Palit. AQSh i RSH, F. 716, D. 2, fl. 2^a-3^a.

5 Ibid: fq. 11.

6 Ibid: fq. 12.




Figura 3: Fillimi i Ungjillit sipas Lukës, AQSh i RSh, material i papërpunuar.

nuk i kanë mbërritur kurrë të dënuarit, siç ishte e zakonshme. Në Dosjen Formulare që mban emrin e tij hasën dhe ca pak letra të tjera, si dhe zarfe bosh, të cilat i dërgoheshin apo dërgonte Át Marku. Sigurisht, nuk janë dërguar kurrë.

NJE SY MBARË UNGJILLIT SI MBAS SH'LUKËS.

Ky shejt Ungjilltar, tue vrojtun jeten e mësimit hyrëor të Je zu ~~XXXXXX~~ Naxaremit, ma se kjarë e shef se A j s ka ardhë vetem per Ebrej, (qi deri diku me arsyë u krenojshin se janë sternipat e Abrahamit), por per të gjithë sa rjerzë. Gjinden sipri faqes së dheut, pa kurrfarë dallimi. I ndritur prej Shpirtit Shejt, qyehë në kap. e tretë (rruv. 23-28), i Sh'Luksa vishë e lëshon bukuri një dritë mbi ket të vertetë kaqe të ngjashllueshme. Këmbi brezit mbarë rreshtue në brezli djer ligjere, qi endë, aj vjër Zoti Krijues: të Ky i Lumi i neper Adamit, qi s pat as babë as nënë, po t'atuel filli prej duerve të gjithpushtueshme të Tij, e qon unji vierzimim. Në fund të kësaqë brezli dje qet Jezu Naxaremit, Zoti Shelbues. Kërdëj per vardë bukuri bar me kuptue e me kujtue, se, sikur prej Ati qielluer kanë rrjedhur të gjithë vierzit me arë të Krijesës, ashtu prej Jezu Naxaremit të gjithë vierzit janë thirrë mele kah jeta mbiratymore me arë të hirit, qi Ky i Lumi na ka meritue me shperblim të vatin.

Prej pushtedes e mëshieses së pakufi të Zoti Shelbues nuk perjashtohet as publikajt si e bar dishmi të shkelqye shme Levi a Mateu, qi Krishti thirrri mbas veti (k. 5, 27), edhe e zgjedh apostull. Ajo zemer hyrëor nuk perjashton as mëkatrorer me flamur a shkar dulloer e qytetit, ku ajo rrinte. I Sh'Luksa me një kujdes të posaçem na e persikrus të kthyerit e sajë tue e rreshtue merrethana a hollai (k. 7 35-50). Në ket mëkatmore t'ent e Nijetarit e Kishës kanë pa të kthyerit e Sh'Mesit Magdalenë. Në tëq thotë i permenuari gojtar frangës, i madhi Monsabre, janë të shembëllueme të gjithë mëkatrorët e perdume të shekujve mbarë. Ajo zemer mëshires së plotë nuk perjashton as idhujtarët ~~XXXXXX~~ as samaritjtat, aq të mënimë, pre Ebrejve, sa i kujtojshin se nuk janë të zot per asnje vepër të mirë, jo ma per mbretëri të Mesit së rrentuem. (1). Per të qitë poshtë një paragjikin kaq trasharik, Shelbuesi i të gjithë vierzve, me njëmjeshtri të pa kurkund shoge, tragor puner e samaritarit të mirë, qi i bahet vëlla rrezikziut, shkallmues e varrueprej oubave rruges së Xeruzalemit, Jerik. Me qellim Ungjilltari e rreshton mbarë e mbarë. (Shëf "ap. 10, rr. 25-37").

Poper ket q'llim aj qet edhe mrekullin e 10 gerbulave pastrueprej Krishti (k. 17, 11-19): vetem një ndër këto dhëtë, një samaritani, kthen e i falet vderës ajkut Hyrëor. E i mëshierëshmi Jezu nuk e lë pa i vu shej kësaj punes prashtu thotë: "E vardë tjetër ku janë?" (rr. 13).

Perqjasimin e samaritarit të mirë e mrekullin e

Figura 4: Një sy mbarë Ungjillit sipas Shën Lukës. AQSh i RSh, material i papërpunuar.

Nga proces-verbali i datës 29.09.1957 i Dosjes Formulare mësojmë se At Marku ka qenë nën vëzhgim të Degës së Ministrisë së Punëve të Brendshme të rrethit Lushnje, i internuar në një nga kampet e zonës, ndoshta në Gradishtë. Nga proces-verbali i datës 10.07.1960 mësojmë

se është transferuar në Savër, dhe në procesverbalin e datës 15.12.1963 mësojmë se ka udhëtuar drejt Tiranës, bashkë me klerikë të tjerë, të cilët kanë qenë internuar me të ose pranë tij. Është koha kur është liruar nga internimi. Në AQSh, F. 716, D. 10, fl. 2, shohim se kartolina e nisur nga Zef Shiroka 03.04.1958, një urim për Pashkët, i dërgohet At Markut në Kuç të Vlorës. Nga vendimi i Komisionit të Dëbim-Internimeve që ndodhet në dosje njoftohemi se fillimisht At Marku është internuar në Kuç, por nuk arrijmë të shohim ndonjë vendim tjetër për lëvizjen e tij, brenda një kohe të shkurtër, me drejtim Gradishtën.

Përkthimi i Dhjatës së Re

Pjesa më interesante e arkivit të At Mark Harapit është përkthimi i Dhjatës së Re. Për autorësinë e përkthimit jemi të sigurt, pasi në një nga fletët hasim shënimin: “Dishmi nënshkrimi. Tue mbarue ket punim fetar, me gëzim po diftoj botnisht se, në daç per krah përkthimimi, në daç per kah skjarimi i gjithcilës ve të frymzuem, jam e mbes per herë i nenshtruem unji Kishës Katolike, si asht shtylla e themeli i së vertetës fetare, si thotë i Sh’Pali Apostull në Letren I Timoteut (k. 3, 15) pse, si mëson Kryetari i Apostujve e i Pari Xevendë i Krishtit në tokë e i Pari Papë, Shkroja Shejtë nuk asht gja per t’a kuptue kush në krye të vet.... (Let. II e Sh’Pjetrit, k. 1,20). At Mark Harapi, Meshtar i Shoqnis Jezu”. Koha e përkthimit është vështirë të përcaktohet me siguri. Sipas Pjetër Pepës, At Marku e përfundoi përkthimin e Dhjatës së Re gjatë internimit.⁷ Kurse një dëshmitar i kohës, Tefik Çelo, i internuar në Savër bashkë me At Mark Harapin, na njofton se At Marku punonte natë e ditë për të përkthyer Ungjillin në shqip.⁸ Këto dy pohime e vështirësojnë përgjigjen ndaj pyetjes se kur është kryer përkthimi. Në qoftë se At Marku ende përkthente në kohën e internimit, ngrihet pyeta se me çfarë forme arriti ta daktilografonte përkthimin? Edhe në qoftë se marrim të mirëqenë mundësinë që gjatë internimit e shkruante me dorë tekstin e përkthimit, misteri bëhet edhe më i madh, po të fantazojmë se pas internimit, një ish i dënuar kishte mundësi të zotëronte një makinë shkrimi. Gjasat janë të pakta, pasi me urdhëresën e Këshillit të Ministrave “Mbi shtypshkronjat, aparatet shumëzuese dhe vulat” të datës 27.07.1962 personat që zotëronin makina shkrimi duhet t’i regjistronin ato.⁹ Një makinë shkrimi, e cila është

7 *Ibid*: fq. 12.

8 <http://www.radiandradi.com/nj%D1%91-plan-i-kobsh%D1%91m-i-djajve-t%D1%91-kuq-teufik-celo/testata-kryesore/gazeta/>, aksesuar për herë të fundit më 30.11.2017. Dëshmia i është dhënë në formë të shkruar Jozef Radit në formë të shkruar në vitin 1992 dhe është botuar elektronikisht më 2013.

9 Urdhëresë nr.8, dt. 27.07.1962, Neni 14. Në AQSh, 14/AP/STR, D. 581 shohim udhëzimet për zbatimin e Urdhëresës. Sipas Nenit 14 të saj, çdo person privat që zotëron një makinë shkrimi duhet ta regjistrojë atë pranë degëve të punëve të brendshme në rrethe, kurse makinat e shkrimit që janë pronë shtetërore mund të përdoren vetëm




Figura 5: Fillimi i Letrës së Palit për Romakët. AQSh i RSh, material i papërpunuar.

edhe mjet propagande, nuk mund të lihej në dorën e dikujt që ishte dënuar si bashkëpunëtor i fashizmit dhe agjent, etj.

Veç dy fletoreve me shkrim dore, të cilat përmbajnë përkthimin e letrave

nga personat e autorizuar.

të Shën Palit¹⁰, gjithë pjesa tjetër e përkthimit është e daktilografuar në letër të bardhë, të hollë, në disa kopje. Përkthimit i paraprin një parathënie e shkurtër e Át Mark Harapit, ku ai shpjegon arsyet që e shtynë të ndërmarrë këtë punë. Më pas, për çdonjërin prej Ungjijve, për Veprat e Apostujve, për Letrat e Përgjithshme të Palit, për Letrat e Palit në përgjithësi dhe për Zbulesën përkthyesi ka përgatitur një pasthënie për çdonjërin prej tyre, ku jep një përmbledhje sinoptike dhe informacione historike lidhur me tekstin dhe autorin e tyre. Përkthimi është i pajisur, po ashtu, me shënime të shumta, ca herë edhe disa faqe të gjata, ku përkthyesi sjell të dhëna historike apo interpretimin e frazës ose pjesëve të tekstit, duke i krahasuar me pjesë të tjera të Biblës në përgjithësi, sipas rastit. Me sa dimë, deri në çastet që shkruajmë ekzistenca e këtij përkthimi është shumë pak e njohur dhe nuk është botuar ende, i pjesshëm apo i plotë.

Pavarësisht vëmendjes së madhe që tregojnë studiuesit në përgjithësi për dokumentet arkivore të periudhës nga fillimi i shek. XX e këtej, arkivat e Shqipërisë ende kanë shumë për të rrëfyer dhe plot aspekte për të zbardhur. Shpresojmë që ky kontribut të shërbejë sadopak drejt përmbushjes së këtij qëllimi.

Bibliografi:

Burime parësore:

AQSh i RSh, Fondi "Mark Harapi" (nr. 716).

AQSh i RSh, Fondi 14/AP/STR, D. 581.

Arkivi i AIDSSH i RSh, Dosje gjyqësore 1221/A

Arkivi i AIDSSH i RSh, Dosja formulare, kategoria II B, nr. 1519.

Burime dytësore:

P. PEPA: *Tragjedia dhe lavdia e Kishës Katolike në Shqipëri*, Tiranë 2007.

Udhërrëfyes i Arkivit Qendror Shtetëror, Fonde personale dhe familjare, Tiranë 2000.

10 Nuk është pa gjasë që pjesë të tjera nga dorëshkrimi i përkthimit të Dhjatës së Re të jenë vendosur, gabimisht, në fonde të tjera, siç tregon shembulli i Dosjes 2 dhe 2/1, të cilat kanë qenë sistemuar, fillimisht, në Fondin "Zef Hardhia (Simoni)".